



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**VENDIM**

**K.P.P. 06/2019**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.01.2019, shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr.1854 prot, datë 11.12.2018 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-88876-10-08-2018 me objekt “*Ndërtim Rruga “Mustafa Lita”* me fond limit 42.094.714 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.11.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

**Ankimues:**

“BE-IS” shpk  
Rruga “Qemal Stafa”, Pallati 66, Shk.3, Ap.24, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Kamëz  
“Bulevardi Blu” nr.492 Kamëz Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor.



#### *Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 08.10.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-88876-10-08-2018 me objekt “*Ndërtim Rruga “Mustafa Lita”*” me fond limit 42.094.714 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.11.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë KPP me shkresën nr. 6656/1 datë 17.12.2018 protokolluar me tonën me nr.1854/3 datë 18.12.2018 rezulton se operatori ekonomik “BE-IS” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor më datë 03.12.2018 me anë të së cilës kërkon kualifikimin e ofertës së tij.

II.3. Me shkresën nr. 6490/1 prot datë 06.12.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës për shkak të paraqitjes së saj jashtë afatit të lejuar ligjor.

II.4. Në datën 11.12.2018 pala ankimuese “BE-IS” shpk., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës me Nr. 6656/1 datë 17.12.2018 protokolluar me tonën me nr.1854/3 datë 18.12.2018 autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.8. Në datën 07.01.2019, operatori ekonomik “BE-IS” shpk ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-88876-10-08-2018 me objekt “*Ndërtim Rruga “Mustafa Lita”* me fond limit 42.094.714 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.11.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik “BE-IS” shpk për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-88876-10-08-2018 me objekt “*Ndërtim Rruga “Mustafa Lita”* me fond limit 42.094.714 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.11.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik i drejtohet ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i cili, në nenin 94 “*Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës*”, pika 1, parashikon se: “*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë*”.

III.1.2. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në objekt ankimimin e tij, dhe si pasojë mos shqyrtimit të ankesës së tij nga KPP lidhur me këto pretendime. Heqja dorë nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues sjell si rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

Për sa mësipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

**Vendos:**

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-88876-10-08-2018 me objekt “*Ndërtim Rruga “Mustafa Lita”*” me fond limit 42.094.714 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.11.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1854 Protokoli; Datë 11.12.2018**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

